



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 05, 07, 08 PARAQITUR  
NË KQZ NË DATËN 28.05.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:**

Partia Komuniste e Shqipërisë  
Partia Ora e Shqipërisë  
Partia Bindja Demokratike

**OBJEKT:**

**KA-05** Kundërshtimi i vendimit nr. 09, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 Belsh "Per mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie z. Jashar Hamit Elezi;

**KA-07** Kundërshtimi i vendimit nr.10, datë 25.05.2019 të KZAZ-së nr.45 Belsh "Per mosregjistrimin e listes shumemeroje per keshillin e bashkise Belsh;

**KA-08** Kundërshtimi i vendimit nr.07, datë 21.05.2019 të KZAZ-së nr.46 Cërrik "Per mosregjistrimin e listes shumemeroje per keshillin e bashkise Cërrik



**Nr. 720 i Vendimit**

**Data 28.05.2019**

**Ora 19:00 e Vendimit**

Për Pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr.05, 07, 08 paraqitur në KQZ në datën  
28.05.2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 129, pika 1, 3, germa "a" dhe neni 126, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### **V Ë R E N:**

Subjekti zgjedhor Partia Kumuniste e Shqipërisë, Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia Bindja Demokratike, kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesat ankimore, të cilat në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, janë regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr.05, 07, 08 regj, datë 28.05.2019.

Në mbledhjen e datës 28.05.2019, ora 19:00 pas relatimit të z. Denar Biba, znj. Edlira Jorgaqi dhe z. Klement Zguri dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesat ankimore nr. 05, 07, 08 i plotësonin elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 dhe në mbështetje të nenit 129 pika 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Kërkesat Ankimore duhet të pranohen.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 126, pika 2, nenin 129, pika 1, 3, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 05, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Komuniste e Shqipërisë, shqyrtimi do të bëhet në datën 30.05.2019, ora 18:00.



**Nr. 720 i Vendimit**

**Data 28.05.2019**

**Ora 19:00 e Vendimit**

Për Pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore nr.05, 07, 08 paraqitur në KQZ në datën 28.05.2019

2. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 07, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Ora e Shqipërisë, shqyrtimi do të bëhet në datën 30.05.2019, ora 18:30.
3. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 08, datë 28.05.2019, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, shqyrtimi do të bëhet në datën 30.05.2019, ora 19:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>

